



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.05.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:06 dhe mbaroi në orën 13:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Sipas njoftimit të bërë dhe krijimit të kuorumit të nevojshëm deklarohet e hapur mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 18 maj 2023, ora 13:00, e drejtuar nga z. Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Kurushi.

Në fjalën e tij z. Kurushi parashtroi se ditën e sotme KZHK ka paraqitur dy relacione. Paraprakisht fillohet me relatimin e relacionit të parë që ka për objekt shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Deri më datë 16. 05.2023, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, kërkesë e parashtruar nga Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Kërkohet caktimi i një gjyqtari për shqyrtimin e çështjes penale me të pandehur {...}, {...} etj. Trupi gjykues që ka marrë në shqyrtim këtë çështje përbëhet nga gjyqtaret znj. Elsa Ulliri dhe znj. Rudina Palloj. Kjo është një dosje e ndarë nga disa çështje të tjera si nr. 21/127 regj, në ngarkim të të pandehurve {...}, {...} etj; e ndarë nga ajo me të bashkëpandehur {...}, {...} etj; Për këto çështje, pra për këtë çështje të fundit për shkak të natyrës së procedimit të lidhur me çështjet e tjera penale që u përmendën, kanë pengesa ligjore gjyqtarët Etleva Deda, Irena Gjoka, Flora Hajredinaj, Erion Çela, Erjon Bani, Rexhep Bekteshi, Esmeralda Xhili, Dritan Hasani, Sokol Pine, Ilir Përdeda, Flojera Davidhi, Atalanta Zeqiraj, Migena Laska, Matilda Llangozi, Aurel Arapi, Besmir Stroka, Diamela Goxha, Artan Çupi.

Ndër të tjera z. Kurushi shprehet se për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit (ku në skemë janë 4 gjyqtarë) dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1(një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se një skemë e tillë e caktimit të gjyqtarëve për atë çështje gjyqësore të veçantë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është mundësia më e mirë për përmbushjen e nevojave të kësaj të fundit.

Bashkëlidhur gjenden edhe emrat e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t'u përfshirë në short.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa nr. 1257), gjyqtarja Olkeda Manellari (Lice).

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.05.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:06 dhe mbaroi në orën 13:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë””, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e dytë e rendit të ditës lidhet me shqyrtimin e projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë””. Fjala sërisht i jepet relatorit z. Klodian Kurushi.

Në fjalën e tij zoti Kurushi parashtron shkurtimisht se kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, më datë 06.02.2023 ka kërkuar caktimin e dy gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, ndaj KLGJ, në mbledhjen e tij plenare të datës 28.03.2023 ka shqyrtuar kërkesën e kësaj gjykate për një çështje penale me objekt akuze “neni 114/a shfrytëzim prostitucioni”. Për shqyrtimin e kësaj çështjeje gjykata e Lushnjës kërkonte 2 gjyqtarë. Trupi gjykues ishte i përbërë nga znj. {...}. Me transferimin

e zonjës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe komandimin e znj. {...} në ILD ishte i nevojshëm plotësimi i trupit gjykues me dy gjyqtarë.

Për këtë kërkesë të paraqitur nga kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në pamundësi të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi KLGJ-së zbatimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të Vendimit të KLGJ-se “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, si dhe në zbatim të paragrafit V, pika 4, të këtij Vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozoi që gjykata nga duhet të përzgjidhej, me short, gjyqtarët që do të caktoheshin për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktoheshin të ishte dy.

Propozimet e KZHK-së u pranuan nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe mbi këtë bazë është zhvilluar procedura e shortit për përzgjedhjen e dy gjyqtarëve.

Kërkesa fillimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë erdhi për një gjyqtar ku zonja {...} ishte anëtare e trupit gjykues, por në kushtet kur trajtimi i kërkesës u pasi Këshilli kishte disponuar me vendim për transferimin e përkohshëm të znj. {...} në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas komunikimit me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, plotësimi i trupit gjykues u bë me dy gjyqtarë.

Mbi këtë bazë, me propozim të KZHK-së u mor vendimi nr. 145, datë 28.03.2023, i KLGJ-së. Në pikën 1, KLGJ vendosi:

Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor z. {...} dhe z. {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore, ndër të tjera, edhe me të pandehurin {...}; Akuza: “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal”.

Pas njoftimit të këtij vendimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka bërë me dije KLGJ-në se: “Rezulton se është kërkuar caktimi i një gjyqtari në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar çështjen penale të sipërcituar. Në këto kushte do të kërkonim nga ana juaj ndryshimin e vendimit nr. 145, datë 28.03.2023.”

Më tej, pas kësaj kërkesë, në një komunikim elektronik që KZHK ka bërë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në vijim është saktësuar se: “Në përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë se çështja në ngarkim të të pandehurit {...} me akuzë “Shfrytëzim prostitucioni” është në fazën e konkluzioneve përfundimtare.”

Këshilli, në pikën 4 të vendimit 97, datë 06.03.2023 i cili ka disponuar për transferimin e përkohshëm me pëlqim të zonjës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, ndër të tjera ka disponuar: “4. Gjyqtarja znj. {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër të caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dorëzohen menjëherë prej saj.”

Sa më sipër rezulton që vendimi i Këshillit i përmendur më lart është bazuar mbi rrethana fakti të cilat nuk i përgjigjeshin në atë kohë realitetit objektiv, sa i përket nr. të gjyqtarëve që duhet të caktoheshin për atë çështje gjyqësore për të cilën ajo gjykatë paraqiste nevojë. Duhej një gjyqtar dhe jo dy gjyqtarë sikurse është disponuar.

Siç u përmend, është disponuar për dy gjyqtarë mbi bazën e propozimit të KZHK-së për shkak se është llogaritur që gjyqtarja znj. {...} ishte transferuar në Gjykatën e Tiranës.

Pas informacionit mbi bazën e komunikimit të vazhdueshëm elektronik, që kjo çështje penale është në fazën e konkluzioneve përfundimtare, normalisht gjyqtarja znj. {...} do të vazhdonte funksionin në bazë të vendimit të Këshillit nr. 97.

Ndodhur në këto kushte, bazuar në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenin 99 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, propozohet që është vendi për ndryshimin e pikës 1, paragrafi i parë, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, të vendimit nr. 145, datë

28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket gjyqtarit të caktuar për gjykimin e një çështjeje penale që u përmend më lart.

Gjyqtari që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, duke mbajtur në konsideratë propozimet e KZHK-së të pranuar nga Këshilli në mbledhjen e datës 28.03.2023 si dhe rezultatet e shortit të zhvilluara si të tillë, mbetet të caktohet gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i përzgjedhur si i pari në short për këtë çështje, pra gjyqtari z. {...}.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

I. Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, paragrafi I, të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

“1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: shtetasin {...}; Akuza: “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal”.

Bashkëlidhur relacionit është përfshirë edhe fleta e shortit e realizuar për këtë qëllim në datën 7 mars 2023 (*lapsus pasi data ka qenë 28 mars 2023*), si dhe bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi përkatës.

Zoti Rusi shtron pyetjen nëse ka diskutime nga anëtarët. Merr fjalën zonja Plaku për pyetje.

(Vijon zbardhja e mbledhje sipas diskutimeve të anëtarëve)

Irena Plaku: Në fakt, doja të dija, në rast se gjyqtari i dytë i caktuar, mos ka zhvilluar ndonjë seancë? Jo {...}, por gjyqtari i mëparshëm. Mos ka zhvilluar nga një seancë sepse nga relacioni kuptova që vendimi i përket muajit mars dhe mos është zhvilluar ndonjë seancë nga gjyqtari tjetër. I bie që ne më pas të heqim atë gjyqtarin përsëri.

Klodian Kurushi: Nga informacioni që kemi marrë ka rezultuar që nuk është shqyrtuar asnjë seancë nga të dy gjyqtarët. Kjo ka qenë arsyeja që në mënyrë të vazhdueshme kemi komunikuar me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Fier tashmë, për të zgjidhur edhe një herë situatën se në cilën fazë ndodhej shqyrtimi i çështjes. Meqenëse çështja ndodhej në fazën e konkluzioneve përfundimtare, gjyqtarja {...} ishte pjesë/anëtare e trupit gjykues në këtë çështje. Kështu që gjyqtari i dytë, zoti Dushku nuk është përfshirë dhe nuk ka shqyrtuar si anëtar i trupit gjykues asnjë seancë gjyqësore në lidhje me këtë çështje.

Irena Plaku: Për këtë pjesë jam dakord. Problemi është që tashmë ka hyrë harta në fuqi dhe të mos shprehemi më “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë” por të themi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e juridiksionit të përgjithshëm. Aktualisht ne po ndryshojmë vendimin që i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, se çështja normalisht ka marrë numrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier tani (besoj).

Klodian Kurushi: Qartë edhe me këtë pjesën tjetër. Por titulli është ndryshimin e vendimit që ne kemi marrë me nr. 145, datë 28.03.2023, në atë kohë ka qenë funksionale Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhe ne kërkojmë të ndryshojmë pjesërisht këtë vendim për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Propozimet e bëra i referohen një vendimmarrjeje të mëparshme, përpara se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë të riorganizohet së bashku me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Irena Plaku: E kuptoj këtë, por duke qenë se sot po e marrim këtë vendim, mos të sjellë parregullsi tek pjesa e administrimit të dosjes, të paktën nga ana administrative (në mënyrën se si regjistrohet). E kuptoj që normalisht ai vendim në atë mënyrë duhej marrë në atë kohë “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, por aktualisht ka ndryshuar situata. Vetëm për këtë hall e kam. Sepse e kuptoj që në atë kohë vendimi ka qenë për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, por gjithsesi për çështje administrative, nuk jam edhe unë shumë e qartë për këtë pjesë.

Ilir Rusi: Nëse mund të them diçka në vijim të kësaj.

Ajo çfarë prezantohet nga zoti Kurushi është që në referim të një nga çështjet që ka të bëjë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimmarrjen nr.145, datë 28.03.2023, në referim të atij ndryshimi që do bëjmë ne tani, në një moment i është referuar aktualitetit kurse në momentin e dytë jo. Në momentin e parë është referuar duke thënë që, nëse do t'i referohem në mënyrë eksplicite, pikës 1 të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, thuhet “gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dhe emrat përkatësisht. Ndërsa tek ndryshimi na vjen “gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, pra do të thotë është reflektuar aktualiteti, që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier tashmë është emërtuar Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, prej datës 30.04. e ka ndërprerë veprimtarinë e vet.

Ajo çfarë shtrohet në raport me diskutimet dhe relacionin, tek ky perifrazim i këtij ndryshimi, do t'i referohemi terminologjisë së datës 28.03.2023 sipas aktualitetit të atëhershëm, apo do t'i referohemi aktualitetit të sotëm? Sepse në një moment është reflektuar aktualiteti i sotëm, që s'është më Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, por është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, dhe përmendet emri i magjistratit - por s'kam lidhje me emrin e magjistratit, e kam me emërtimin – ndërsa në vijim vazhdohet me emërtimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë që tashmë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk ekziston më sepse e ka ndërprerë veprimtarinë, dhe ky trup gjykues do gjykojë për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Kjo është çështja që shtrohet. O do t'i qëndrojmë motamo perifrazimit që kemi bërë tek vendimi nr. 145, datë 28.03.2023, duke lënë një gjyqtar për të gjykuar këtë çështje, ose do t'i referohemi aktualitetit të emërtimeve të sotme. Në kllapa mund ta vëmë pas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, tashmë është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, se s'ka më Gjykatë të Rrethit Gjyqësor Lushnjë sot. Ndërsa emërtimin se ku gjyqtari ushtron funksionin e keni ndryshuar. Kjo është çështja.

Klodian Kurushi: Atëherë edhe një herë ndjesë për ndërhyrjen.

Çështja në emërim të titull është “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë””, pra ne i referohemi me këtë pikën e parë rregullimit të pjesshëm të vendimmarrjes që ne kemi marrë më përpara në lidhje me kërkesën e bërë në atë kohë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Në pikën e dytë të projektvendimit që ne e propozojmë të miratohet sot në Këshill, është pasqyruar edhe gjendja faktike se ku ndodhet dosja dhe se ku do shqyrtohet kjo dosje, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk ekziston më. Në pikën e dytë ne jemi referuar gjykatave aktuale, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në kuadër të riorganizimit të hartës, janë përfshirë së bashku si një gjykatë e vetme që është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Pra të dyja situatat dhe të dyja meraket që kemi neve janë të përfshira në propozimet e bëra në projektvendimin tonë. Meraku i parë, shqetësimi i parë lidhet me referencën se kujt vendimi ne duhet t’i referohemi për të kërkuar ndryshimin e tij, dhe shqetësimi i dytë lidhet me gjykatën aktuale, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk ekziston por në kuadër të riorganizimit bashkëvepron e lidhur me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, që së bashku sot përfaqësojnë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Nuk e di se sa i qartë isha.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka ndonjë diskutim nga anëtarët e tjerë?

Brikena Ukperaj: Mundem zoti Rusi?

Ilir Rusi: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Në fakt unë nga materialet që kam, kam relacionin e propozuar nga Komisioni dhe dakordësohem me pjesën e prezantimit të bërë nga zoti Kurushi por edhe atë çka thotë Irena, thjesht tek titulli nëse mundemi, pas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, të themi “sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, për ta saktësuar. Ta lejmë titullin e vendimit siç është, por të

saktësojmë “sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”. Ndërsa, tek pjesa e disponimit sigurisht që nuk duhet ta përmendim pjesën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, por do themi: “Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier z. {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari jo të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, por për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, sepse po e ndryshojmë atë vendimin. Thjesht në titull ta saktësojmë “sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier” dhe në pjesën e ndryshimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk duhet të ekzistojë më sepse tashmë është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Që të jemi unison me termat.

Ilir Rusi: Janë tre diskutime deri tani në të mirë, për miratimin e këtij projekt-akti. Kështu që do kërkoja një fjalë përmbledhëse nga zoti Kurushi, duke marrë në konsideratë edhe ndërhyrjet nga anëtarët.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Ne i qëndrojmë atyre propozimeve që kemi bërë. Kam përshtypjen se të gjithë jemi në të njëjtin mendim. Kështu që në këtë pikë ne i qëndrojmë atij propozimi. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Klodi të lutem, mund ta lexosh dispozitivin e vendimit që do marrim të saktë sipas propozimit, sepse unë vetëm relacionin kam. Të lutem!

Si do jetë dispozitivi i vendimit që do marrim sot?

Klodian Kurushi: Atëherë, siç është shënuar kam përshtypjen.

Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, paragrafi I, të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: “1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal”.

Brikena Ukperaj: Domethënë vazhdon të mendosh që të themi që caktohet për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë?

Klodian Kurushi: Sepse neve rregullojmë një vendim të cilin e kemi marrë në kohë më përpara dhe në këtë vendim, duke iu referuar edhe aktualitetit, nuk shkon që gjyqtari i rrethit gjyqësor Fier z. {...}, të gjykojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier me shortin që ka kaluar me vendim të KLGJ-së. Dhe kjo është arsyeja pse duhet ta vendosim Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për të bërë diferencën dhe për të kuptuar edhe qëllimin e hedhjes së shortit, pra nga Fieri do shkonte në Lushnjë. Ne sot rregullojmë atë situatë që na ka kaluar më përpara.

Brikena Ukperaj: E kuptoj. Atëherë, të mos e themi që “caktohet për të gjykuar për llogari”, thjesht “caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar çështjen gjyqësore”, kaq dhe nuk e themi për llogari të kujt gjykate.

Klodian Kurushi: Dakord. Është thënë më përpara me idenë që të bëjmë diferencën, se nga Fieri nuk do të shkonte në Fier. E kupton zonja Ukperaj? Kjo është arsyeja pse e kemi vënë.

Brikena Ukperaj: Jam dakord me logjikën që ai është gjyqtar i asaj gjykate dhe s’mund të shkojë/të caktohet dot, por nëse do bëjmë ndryshimin e vendimit tonë, ne nuk mund të përmendim më asnjë gjykatë tjetër, duke qenë se ai gjyqtar është gjyqtar i asaj gjykate. Pra ai gjyqtar është gjyqtar i asaj gjykate. Thjesht të heqim “për llogari”, por themi që “gjyqtari caktohet në përbërjen e trupit gjykues”. Jo për llogari të ndonjë gjykate.

Klodian Kurushi: Ne nuk fshehim gjë. Edhe kjo që thoni ju është e nënkuptuar, apo jo. Se ne nuk fshehim gjë në këtë rast. Nëse i heqim emrin Lushnjës, ok, nuk ka asnjë lloj ndryshimi.

Brikena Ukperaj: E heqim fare pjesën që “caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar çështjen gjyqësore”. Ajo “në llogari të kujt gjykate” të hiqet, -mendoj unë. Jam plotësisht dakord me arsyetimin tuaj që s’mundet që të thuhet kur ai është gjyqtar i asaj gjykate dhe çështja po gjykohet në atë gjykatë, nuk mund të thuhet për llogari të një gjykate tjetër. Pra ai është gjyqtar i asaj gjykate dhe po gjykohet çështja në atë gjykatë. Kështu që thjesht të themi që caktohet në përbërje të trupit gjykues për të vijuar gjykimin e çështjes që kemi. Mos të themi “për llogari të Gjykatës së Lushnjës”. Ta heqim fare si togfjalësh. Ndoshta do të ishte më mirë.

Klodian Kurushi: Nuk e di! Unë e kuptoj më mirë dhe jam më i qartë dhe kjo është arsyeja pse e kam vendosur Lushnjën, sepse jo vetëm korrigjojmë por e kuptojmë që shorti është hedhur për Lushnjën në atë kohë.

Brikena Ukperaj: Dakord. Në relacion e kemi thënë. Në relacion e shpjegojmë saktësisht këtë gjë, por kur flasim në dispozitiv që shkon për llogari të asaj gjykate...

Klodian Kurushi: Pikërisht, edhe dispozitivi duhet të përkojë me relacionin, mendoj unë. Edhe ai pasqyrim që ne kemi bërë në relacion shkon tek dispozitivi i këtij projektvendimi që propozojmë ne. Domethënë, ideja ime është që ne nuk fshehim gjë në këtë pikë. Edhe po të heqim Lushnjën, ne prapë asaj gjendjeje faktike i referohemi, vendimit që kemi marrë në mars të vitit 2023. Për Lushnjën e kemi marrë atë vendim. Pra ne rregullojmë vetëm një situatë që nuk i është përshtatur realitetit objektiv të asaj kohe.

Brikena Ukperaj: Dakord Klodi, por ne po ndryshojmë vendimin, nuk është se po korrigjojmë ndonjë gabim material dhe ndryshimin e vendimit duhet ta përshtatim me situatën aktuale. Në kushtet kur në relacion e shpjegojmë, nuk mundet të themi në

dispozitiv që të caktohet për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë sepse ajo çështje nuk është më çështje e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë është çështje e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e shkallës së parë. Kështu që nëse mund ta heqim, do ta kemi më të qartë, mendoj.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ne sot nuk hedhim çështje në short, ne nuk bëjmë short, nuk bëjmë një procedurë të re, ne sot rregullojmë, ndryshojmë pjesërisht një vendim që ne e kemi marrë tashmë, e kemi marrë si vendim në mars të vitit 2023 dhe arsyeja pse e ndryshojmë është ajo çka kemi thënë në relacionin përkatës. Rregullojmë vetëm përbërjen e trupit gjykues. Pra ai ka qenë i rregulluar tashmë por ne vetëm e cilësojmë që një anëtar i trupit gjykues nuk duhet të marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje sepse është gjyqtari. Këtë po themi. Short nuk bëjmë sot. Domethënë shorti është bërë, veprimet janë të bëra më përpara dhe janë bërë të gjitha për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Prandaj them që s’kemi pse ta fshehim. Lushnja na e ka bërë si kërkesë në atë kohë dhe i jemi përgjigjur përpara hartës. Ajo çfarë na e komplikon pak situatën është ndryshimi që ka pësuar Gjykata e Lushnjës dhe Gjykata e Fierit në një gjykatë të vetme për shkak të hartës, por ky ndryshim nuk e zhbën trupin gjykues. Ai ka qenë.

Brikena Ukperaj: Klodi jam dakord me ty. Nuk kundërshtoj asgjë. Ideja është për t’u shprehur në mënyrë sa më të saktë. Në kushtet kur ne po ndryshojmë një akt që kemi prodhuar me një akt administrativ që do prodhojë pasoja nga sot dhe në të ardhmen, nuk mund të shprehemi në pikën 1 “për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”. E heqim “për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, dhe vazhdojmë “në përbërje të trupit gjykues çështjen gjyqësore me të pandehur”. E heqim vetëm këtë pjesën “për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, se nuk tingëllon mirë. Nuk është çështja e kësaj gjykate. Ky ndryshim nuk ka pasoja prapavepruese. Ky ndryshim bëhet nga sot dhe për të ardhmen, se ata nuk kanë kryer asnjë veprim. Për këtë arsye e kam.

Klodian Kurushi: E qartë! Dakord!

Mbase ne të dy biem në të njëjtin përfundim, apo jo?

Për mua që e kam hartuar këtë relacion dhe kam përpiluar këtë projektvendim, më bënte më tepër sens ta citoja këtë pjesën edhe në propozimin përkatës sepse kështu bëhet edhe diferenca e rregullimit që bëjmë sot dhe e lidhur me kohën kur ka ndodhur veprimi, pra në kohën kur ekzistonte Gjykata e Lushnjës. Nëse vendosja e Gjykatës së Lushnjës nuk përbën sens se mund të sjellë pasoja të padëshiruara, unë jam dakord, edhe mund ta heqim. Por unë po them, unë që e kam hartuar, më bën më tepër sens të ekzistojë sepse në këtë pikë ne bëjmë edhe diferencat që unë i shpjegova më lart, më përpara.

Ilir Rusi: Atëherë, duke marrë në konsideratë këto diskutime, se nuk është se janë propozime, zoti Kurushi, kush do jetë perifraximi fundor i këtij ndryshimi që do bëhet nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje?

Klodian Kurushi: Më falni, nuk thashë se mund të bëjmë ndonjë ndryshim. Mua më shkon më shumë që të ekzistonte edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në propozimin e projektvendimit. Pastaj ta vlerësoj Këshilli.

Ilir Rusi: Po pra, një ndryshim në përmbajtjen e referuar nga ana juaj si relator, kjo është ideja. Do reflektoni në raport me diskutimet apo do t'i qëndroni këtij perifraximi që keni bërë nëpërmjet aktit që na është përcjellë si relacion për këtë çështje?

Klodian Kurushi: Atëherë, më falni edhe një herë, për ta sqaruar.

Ne propozimin e kemi bërë duke përfshirë edhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, si propozim të projektvendimit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë, zonja Ukperaj do kaloni në ndonjë propozim konkret apo nuk do e vijoni diskutimin më tej?

Brikena Ukperaj: Propozimi im ishte në titull, pas fjalës “Lushnjë”, të shtohet

“sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë” dhe në pikën 1, togfjalëshi “për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë” të hiqet.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka propozime të tjera?

(Nuk ka propozime të tjera.)

Atëherë, fillimisht hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Ukperaj në lidhje me titullin e projektvendimit.

Urdhëro!

Ridvan Hado: A mund ta marrë fjalën?

Ilir Rusi: Po, zoti Hado!

Ridvan Hado: Tek pika 1, aty ku thotë “për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, unë jam i mendimit që të shtojmë aty “sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm”, bashkë me atë ta lëmë “për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, dhe është e zgjidhur e gjitha edhe me të kaluarën edhe me të tanishmen. Kaq kisha. Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë, zoti Hado, propozimi juaj është që të kemi një shtesë vetëm në titullin e saj dhe tek pika 1 të mos ndryshojë?

Ridvan Hado: Të jetë ashtu siç është por mbas “Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, në kllapa “sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”. Dhe vazhdon pjesa tjetër siç është.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka propozime të tjera?

Brikena Ukperaj: Unë nuk dakordësohem me zotin Hado, më falni, vetëm për faktin që zoti {...} në fakt është gjyqtar i asaj gjykate dhe ne nuk caktojmë gjyqtarët e asaj gjykate për të shqyrtuar çështje të asaj gjykate. Për këtë arsye thashë që të hiqet fare dhe të biem në unison me pjesën që meqenëse trupi gjykues është formuar, ky do të jetë gjyqtari që do të vazhdojë gjykimin. Për këtë arsye thashë që të hiqet fare togfjalëshi, sepse nuk shkon edhe me rregulloren edhe me mënyrën se si ne disponojmë, që caktojmë një gjyqtar të asaj gjykate për të gjykuar për llogari të asaj gjykate. Prandaj thashë të hiqet “për llogari”.

Ilir Rusi: Ka propozime të tjera?

Atëherë në radhën e kronologjisë së ndodhur në lidhje me propozimet, fillimisht doja edhe një herë mirëkuptimin e zonjës Ukperaj për të bërë perifrazimin e propozimit, se meqenëse është propozim i parë, do hidhet propozimi i zonjës Ukperaj fillimisht në votim dhe pastaj më tej. Zonja Ukperaj, atëherë perifrazoni pak ndryshimin ju lutem, që ka të bëjë me propozimin tuaj.

Brikena Ukperaj: Atëherë, dy ndryshimet janë i) shtimi në titull “sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, dhe ii) pika 1, të hiqet togfjalëshi “për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”. Të mbetet formulimi: Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...} caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar çështjen gjyqësore me të pandehur {...}, etj, me akuzën përkatëse.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Hedhim në votim propozimin e zonjës Ukperaj!

Irena Plaku: Pro, sepse në fakt këtë mendim kisha edhe unë, që nuk duhet të themi më Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për sa kohë që çështja nuk është ekziston më në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe çështja është e regjistruar tek Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Pjesërisht kundër. Pra jam dakord pjesërisht me shtesën që propozova.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Ilir Rusi: Zoti Hado edhe një herë ju lutem.

Ridvan Hado: Jam kundër ose jam dakord duke shtuar atë pjesën në pikën 1 që propozova.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Unë dakordësohem me propozimet e Komisionit. Kështu që kundër diskutimeve të tjera dhe propozimeve të tjera.

Brikena Ukperaj: Dakord me propozimin.

Klodian Kurushi: Me këto propozimet e reja unë jam kundër. Jam dakord, siç e thashë më përpara, me propozimet që ne kemi bërë si Komision. Faleminderit!

Ilir Rusi: Kundër.

Atëherë, rrëzohet propozimi i zonjës Ukperaj.

Ilir Rusi: Atëherë, vazhdojmë me propozimin e zotit Hado.

Zoti Hado, cili ishte propozimi juaj?

Perifrazoje pak!

Zoti Hado!

Propozimi i zonjës Ukperaj nuk u miratua. Vazhdoni me propozimin tuaj!

Ridvan Hado: Në pikën 1 të dispozitivit të projektvendimit apo të vendimit, pas “për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, të vendoset “sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”. Kaq. Pjesa tjetër të jetë po njësoj.

Ilir Rusi: Atëherë, hedhim në votim propozimin e zotit Hado.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Pro.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

Rrëzohet edhe ky propozim.

Ilir Rusi: Atëherë, zoti Kurushi, perifrazoje edhe një herë përfundimisht relacionin e bërë nga ana juaj, me qëllim që ta hedhim në votim.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, ne propozojmë: I. Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, paragrafi I, i vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: “1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ky është propozimi ynë.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Hedhim në votim propozimin e bërë nga relatori.

Irena Plaku: Pro, se u miratua nga Këshilli.

Dritan Hallunaj: Dihet, pro.

Ridvan Hado: Pro, me rezervën që shpreha në propozimin tim.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Pro, dhe ju falënderoj për mbështetjen dhe për përkrahjen në këtë propozim.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë””.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

I. Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, paragrafi I, të vendimit nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: “1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këtë vendimmarrje dhe me trajtimin e çështjeve që kishim në rend dite në mbledhjen e sotme, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Pasdite të qetë!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor